



INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

PROGRAMET E KURRIKULËS BËRTHAMË TË GJIMNAZIT

FUSHA: SHKENCA SHOQËRORE

LËNDA: GJEOGRAFI

KODI: 8.3.12.B

PROGRAMI I LËNDËS SË GJEOGRAFISË

PËR KLASËN E 12^{të}

TIRANË, PRILL 2010

Programi i lëndës "Gjeografia e Republikës së Shqipërisë dhe e trevave të tjera shqiptare" për klasën e 12-të të gjimnazit trajton në mënyrë komplekse problemet gjeografike të hapësirës shqiptare nga pikëpamja rajonale. Ai synon formimin e koncepteve shkencore tek nxënësit mbi veçoritë gjeografike të natyrës shqiptare dhe vlerat e trashëgimisë natyrore e kulturore, mbi potencialet natyrore dhe njerëzore për zhvillimin ekonomik dhe turistik, mbi problemet gjeografike të sistemeve humane shqiptare: popullsia dhe ekonomia, të shtrira në kohë e hapësirë, mbi bashkëveprimin e ndërsjellë ndërmjet sistemeve natyrore dhe humane, në të gjitha trevat shqiptare.

Ky program është ndërtuar duke marrë në konsideratë veçoritë konjitive, psikologjike e sociale të nxënësve dhe ofron mundësi të të nxënësve dinamik. Ai nuk mbetet thjesht në nivelin analitik të përshkrimit të dukurive e veçorive gjeografike të trevave dhe rajoneve shqiptare. Përkundrazi, duke i vendosur ato në plan krahasues me njëri-tjetrin, programi synon të zhvillojë tek nxënësit aftësi të analizës e vlerësimit të tipareve natyrore, demografike, ekonomike e kulturore për çdo rajon dhe njësi gjeografike. Për më tepër, përmes kësaj lënde, nxënësit aftësohen të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese mbi faktorët dhe kushtet e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë shqiptare dhe të njohin se si vlerat e qëndrimit ndikojnë dhe ndikohen nga mjedisi.

Kurrikula e lëndës "Gjeografia e Republikës së Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare" për klasën e 12-të të gjimnazit, ka për mision të kontribuojë në përgatitjen e të gjithë nxënësve për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje që ndihmojnë në zhvillimin e tyre si individ dhe të komunitetit në nivel lokal, kombëtar e ndërkombëtar. Të kuptuarit e saj bën të mundur debatin dhe shkëmbimin e mendimeve ndërmjet nxënësve. Ajo u mundëson të gjithë nxënësve kërkimin shkencor, të menduarit problemzgjdhës, krijues dhe kritik.

Gjeografia e Republikës së Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare, duke ofruar njohuri për tiparet e natyrës, pasuritë natyrore, popullsinë dhe aktivitetet e saj zhvillon ndjenjën e identitetit kombëtar, atdhedashurisë dhe ndihmon në krijimin e qytetarit të ndërgjegjshëm për mirëkuptimin, bashkëpunimin dhe tolerancën në vend, në rajon dhe më gjerë.

1. SYNIMI I LËNDËS

Programi i lëndës Gjeografia e Republikës së Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare synon që nxënës/i-ja:

- të fitojë njohuri mbi diversitetin natyror dhe human të trevave shqiptare; veçoritë natyrore, social-ekonomike, kulturore e mjedisore të rajoneve dhe ndërveprimin midis tyre;
- të zhvillojë aftësi për të parashikuar perspektivën e zhvillimit të trevave shqiptare dhe të bashkëpunimit midis tyre, si dhe bashkëpunimin e integrimin në nivel rajonal, evropian e global.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij programi, nxënës/i, -ja:

- të analizojë dhe vlerësojë modelet dhe diversitetin e sistemeve natyrore dhe humane të trevave shqiptare; faktorët, kushtet, shkaqet që kanë kushtëzuar këto modele dhe diversitete;
- të vlerësojë lidhjet dhe marrëdhëniet ekonomike, kulturore dhe mjedisore ndërmjet trevave shqiptare dhe vendeve ku ato ndodhen, me Bashkimin Evropian dhe vende të tjera të botës;
- të shpjegojë ndikimin e zhvillimeve aktuale globale në botën shqiptare;
- të përcaktojë dallimet rajonale, duke përdorur konceptet rajon, nënrajon, zonë, etj;
- të përdorë metodat dhe mjetet e kërkimit gjeografik për mbledhjen, vlerësimin, organizimin dhe interpretimin e informacionit;
- të zhvillojë, përmes studimit të gjeografisë kombëtare, aftësitë qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre për në jetë, në punë dhe në shoqëri.

3. OBJEKTIVA SIPAS LINJAVE

Linja: Vendndodhja gjeografike

Përshkrim i linjës: Kjo linjë ka për qëllim të paraqesë një tablo të qartë mbi hapësirën që zënë trevat shqiptare në Ballkan, në Evropë dhe më gjerë. Linja synon të formojë tek nxënësit koncepte të qarta mbi rëndësinë e pozitës së trevave shqiptare si në aspektin natyror dhe në atë gjeopolitik. Nxënësit aftësohen të bëjnë analiza krahasuese të ndryshimeve të hartës politike të trevave shqiptare.

Orë të sugjeruara¹: 3 orë

Bloku tematik	Objektiva
Hapësira gjeografike e trevave shqiptare	<p>Në përfundim të klasës së 12^{të}, nxënësi/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë objektin e studimit të kësaj lënde, vendin që ajo zë në studimet gjeografike dhe rëndësinë e studimit të saj; - të bëjë dallimin (të diferencojë) në përbërjen e trevave shqiptare (Republika e Shqipërisë, Kosova, trevat shqiptare në Serbi, në Maqedoni, në Greqi dhe në Malin e Zi). - të analizojë pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Ballkan, Mesdhe, Evropë dhe më gjerë; - të vlerësojë rolin e kësaj pozite në veçoritë natyrore

¹ Orë të sugjeruara janë orët e planifikuara për zhvillimin e linjës. Shuma totale e orëve të linjave duhet të jetë sa numri i plotë i orëve në planin mësimor për këtë lëndë. Quhen të sugjeruara sepse i jepet liri përdoruesit të programit që të shtojë ose pakësojë numrin e sugjeruar të orëve në masën 10 % sipas nevojave të klasës.

	<p>gjeografike, në popullimin e trevave dhe zhvillimin ekonomik, dhe pasojat e kësaj pozite në copëtimin e trevave shqiptare;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë ndryshimet që ka pësuar në kohë dhe në hapësirë harta politike e trevave shqiptare; - të realizojë një projekt kërkimor me karakter krahasues mbi ndryshimet në kohë të hartës politike të trevave shqiptare.
--	---

Linja: Sistemet fizike

Përshkrim i linjës: Peizazhet e larmishme që ofrojnë trevat shqiptare, ndërtimi gjeologjik dhe relievi e faktorët që ndikojnë në formimin e tij, pasuritë klimatike dhe hidrografike, bota e gjallë e tyre etj., krijojnë atë diversitet mjaft të spikatur të mjedisve të trevave shqiptare. Nxënësit propozojnë rrugëzgjdhje për problemet e shkallës së lartë të degradimit dhe shkretirizimit të peizazheve, përmytjeve, ndër problemet më shqetësuese të mjedisit sot në këto treva.

Orë të sugjeruara: 9 orë

Blloku tematik	Objektiva
Diversiteti i mjedisve dhe peizazheve të trevave shqiptare	<p>Në përfundim të klasës së 12^{të}, nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë varietetin e peizazheve dhe hartën e mozaikut të tyre; - të analizojë etapat e formimit të truallit të trevave shqiptare, përbërjen litologjike dhe strukturore të tij dhe rolin e tyre në pasuritë e shumta minerare; - të evidentojë faktorët e formimit të relievit, sistemet kryesore të tij; - të përshkruajë raportin njeri-mjedis në peizazhet e larmishme të trevave shqiptare (peizazh lumor, malor, fushor, kodrinor, karstik dhe bregdetar); - të evidentojë tiparet kryesore të klimës së trevave shqiptare; - të vlerësojë rolin dhe ndikimin e klimës në dukuritë e tjera natyrore, në shpërndarjen e popullsisë dhe aktivitetet e saj; - të analizojë larminë dhe pasurinë e madhe hidrografike të trevave shqiptare; - të vlerësojë rëndësinë jetësore dhe ekonomike të pasurive hidrike të trevave shqiptare; - të analizojë kushtet dhe faktorët e formimit të tokave të larmishme të trevave shqiptare; - të analizojë faktorët e kushtet që kanë ndikuar në shkallën e

	<p>lartë të degradimit, shkretirizimit dhe përmytjeve të tokave si dhe pasojat e tyre;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë faktorët dhe kushtet që kanë përcaktuar larminë dhe pasurinë e madhe bimore dhe shtazore të trevave shqiptare; - të vlerësojë përmes një projekti në grup larminë dhe pasurinë e madhe natyrore të trevave shqiptare (si p.sh. reliev, klimë, hidrografi, etj).
--	--

Linja: Sistemet humane

Përshkrim i linjës: Nxënës/i-ja analizon gjendjen dhe ndikimin e faktorëve ekonomikë, socialë, politikë e kulturorë mbi fizionominë dhe dinamikën e popullsisë shqiptare, ekonomisë e sektorëve të saj si dhe ndikimin e organizimit të sotëm politiko-administrativ të trevave shqiptare në zhvillimin e integrimin rajonal dhe evropian të tyre.

Orë të sugjeruara: 12 orë

Bloku tematik	Objektiva
Organizimi administrativ i trevave shqiptare	<p>Në përfundim të klasës së 12^{te}, nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të pasqyrojë ndryshimet në organizimet administrativo-tokësore në Republikën e Shqipërisë, në Republikën e Kosovës dhe në trevat e tjera shqiptare; - të analizojë organizimin e sotëm politiko-administrativ të trevave shqiptare; - të argumentojë ndikimin e organizimit të sotëm politiko-administrativ të trevave shqiptare në zhvillimin dhe integrimin rajonal dhe evropian të tyre.
Popullsia dhe vendbanimet	<ul style="list-style-type: none"> - të analizojë kushtet dhe faktorët që kanë ndikuar në popullimin e trevave shqiptare; - të përshkruajë elementët (karakteristikat) kryesore demografike të popullsisë së trevave shqiptare (numri i popullsisë, shtimi natyror, struktura e popullsisë); - të analizojë procesin e migrimit si promotorin e të gjitha ndryshimeve demografike të popullsisë shqiptare, duke u ndalur në periudhën pas vitit 1990; - të evidentojë territoret ku kanë migruar shqiptarët me veçoritë dhe problemet e integritetit të tyre; - të diskutojë mbi elementë të identitetit kombëtar të trevave shqiptare (gjuha, toleranca fetare, marrëdhëniet ndëretnike); - të analizojë ecurinë e zhvillimit të popullsisë dhe vendbanimeve në trevat shqiptare, përmes treguesve statistikorë, grafikë, etj.

Ekonomia e trevave shqiptare	<ul style="list-style-type: none"> - të evidentojë potencialet natyrore dhe humane të trevave shqiptare dhe ndikimin e tyre në shkallën e zhvillimit ekonomik të këtyre trevave; - të analizojë rolin e sektorëve të veçantë të ekonomisë në zhvillimin e trevave shqiptare (ekonominë bujqësore, industrinë, tregtinë, transportin, turizmin, shërbimet dhe artizanatin); - të vlerësojë përmes një detyre tematike problemet aktuale dhe të ardhmen e zhvillimit ekonomik të trevave shqiptare, duke i parë dhe trajtuar ato në kushtet e integritetit rajonal dhe evropian.
-------------------------------------	---

Linja: Ndërveprimi njeri/mjedis

Përshkrim i linjës: Në këtë linjë prezantohen vlerat e veçanta natyrore dhe historiko-kulturore të trevave shqiptare, analizohet ndikimi i shoqërisë njerëzore në cilësinë e mjedisve gjeografikë dhe shfrytëzimin e resurseve. Nxënësit aftësohen të paraqesin modele të strategjive alternative që i përgjigjen politikave të veçanta dhe programeve për përdorimin e burimeve dhe menaxhimin e tyre. Ata jo vetëm njohin dhe evidentojnë potencialet turistike të trevave shqiptare, por parashikojnë mundësitë e mirë-menaxhimit të tyre.

Orë të sugjeruara: 6 orë

Bloku tematik	Objektiva
Mjedisi dhe turizmi i trevave shqiptare	<p>Në përfundim të klasës së 12^{të}, nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë vlerat natyrore dhe historiko-kulturore të trevave shqiptare, në varësi me veçoritë e specifikat e tyre; - të veçojë disa nga sitet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore kombëtare (përfshirë ato që janë pjesë e trashëgimisë botërore) të trevave shqiptare; - të vlerësojë rëndësinë e pasurisë natyrore dhe kulturore të trevave shqiptare për zhvillimin turistik të tyre, gjendjen aktuale dhe mundësitë për zhvillimin e ardhshëm të turizmit; - të evidentojë faktorët dhe pasojat e problemeve mjedisore kryesore sot (ndotja e ajrit, ujit, tokës); - të parashikojë rrugë të menaxhimit efektiv të këtyre problemeve mjedisore; - të hartojë një plan veprimi për zgjidhjen e problemeve mjedisore të një zone informale në qytetin ku banon ose për qytete të tjera të vendit me problematika të spikatura mjedisore; - të evidentojë potencialet turistike dhe zonat më të rëndësishme

	<p>për zhvillimin e turizmit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë raportin shfrytëzim/mbrojtje/mirë-menaxhim i potencialeve turistike; - të realizojë një detyrë kërkimore mbi ekoturizmin dhe zhvillimin e tij në Shqipëri (koncepti, infrastruktura, ndikimi mbi mjedis); * - të realizojë një detyrë kërkimore mbi zonat e mbrojtura natyrore, pasurinë e tyre, tërheqjen e turistëve drejt tyre, ndikimin e zhvillimit të turizmit mbi to. *
--	---

* Në bllokun tematik "Mjedisi dhe turizmi i trevave shqiptare" është parashikuar të realizohet një nga detyrat tematike të dhëna në program. Programi ofron dy detyra tematike duke i dhënë mësuesit mundësi të zgjedhë midis tyre atë që është më interesante për nxënësit, ose të punojë me 2 grupe brenda klasës duke i dhënë secilit grup detyrën e tij.

Linja: Rajonet gjeografike

Përshkrim i linjës: Në këtë linjë, nxënës/i-ja analizon dhe vlerëson për çdo rajon tiparet specifike natyrore, demografike, ekonomike, duke i vendosur kështu në plan krahasues me njëri – tjetrin. Në këtë mënyrë ai/ajo do të kuptojë ndikimin e veçorive fizike dhe humane në proceset dhe fizionominë e rajoneve dhe nënrajoneve të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe të trevave të tjera shqiptare.

Orë të sugjeruara: 38 orë

Bloku tematik	Objektiva
Rajonet gjeografike të trevave shqiptare	<p>Në përfundim të klasës së 12^{te}, nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të evidentojë kriteret e përcaktimit të rajoneve gjeografike të trevave shqiptare, ndarjen rajonale të trevave shqiptare dhe tipat e rajoneve.
Republika e Shqipërisë	<ul style="list-style-type: none"> - të analizojë tiparet specifike natyrore, demografike dhe ekonomike që dallojnë Republikën e Shqipërisë nga trevat e tjera shqiptare dhe faktorët e diferencimit të saj rajonal; rajonet gjeografikë; - të vlerësojë akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Shqipërisë me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe evropian.

<p>Rajoni Perëndimor</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë veçoritë kryesore natyrore të Rajonit Perëndimor dhe ofertat potenciale natyrore për zhvillim; - të evidentojë karakteristikat kryesore të popullimit të këtij rajoni, me fokus të veçantë rritjen e shpejtë të popullsisë dhe ndryshimet strukturore të saj; - të analizojë urbanizimin e shpejtë të këtij rajoni dhe rrjedhojat e tij; - të vlerësojë diversitetin e hapësirave të prodhimit bujqësor e industrial, sektorit terciar, rrjetin e transportit dhe rolin e tij në prirjen e organizmit të ri hapësinor të rajonit; - të vlerësojë trashëgiminë natyrore dhe kulturore të rajonit për qëllime turistike, etj; - të parashikojë mundësitë e perspektivës së zhvillimit të rajonit; - të realizojë në grup një detyrë tematike mbi potencialet turistike të këtij rajoni dhe strategjitë për zhvillimin e tyre; * - të realizojë në grup një projekt mbi veçoritë e urbanizimit të këtij rajoni dhe pasojat e tij; * - të krahasojë hartat ekonomike të zhvillimit të Rajonit Perëndimor në periudha të ndryshme.
<p>Rajoni Verior dhe Verilindor</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë mozaikun natyror të Rajonit Verior dhe Verilindor dhe ofertat potenciale natyrore për zhvillim; - të analizojë tendencën e ndryshimeve demografike të këtij rajoni me problematikat që e shoqërojnë; - të evidentojë tiparet kryesore të aktivitetit aktual ekonomik të kufizuar të këtij rajoni; - të vlerësojë trashëgiminë natyrore dhe kulturore të rajonit për qëllime turistike, etj; - të realizojë një projekt (individual ose në grup) mbi mundësitë e zhvillimit në kushtet e reja të ndërtimit të korridorit Durrës-Prishtinë dhe të bashkëpunimit rajonal e më gjerë; - të ndërtojnë hartën e resurseve natyrore të Rajonit Verior dhe Verilindor duke analizuar mundësitë e shfrytëzimit të tyre për zhvillimin social ekonomik.
<p>Rajoni Juglindor</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë veçoritë natyrore kryesore të Rajonit Juglindor; - të analizojë karakteristikat kryesore demografike të këtij rajoni; - të evidentojë tiparet kryesore të aktivitetit ekonomik aktual të Rajonit Juglindor; - të diskutojnë rreth trashëgimisë së pasur natyrore e kulturore të këtij rajoni dhe rëndësinë e veçantë të kësaj trashëgimie për

<p>Rajoni Jugor</p>	<p>zhvillimin e turizmit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të ndërtojë hartën e infrastrukturës rrugore të Rajonit Juglindor duke evidentuar rolin e saj në integrimin dhe bashkëpunimin me shtetet fqinje dhe më gjerë. - të analizojë tiparet e përgjithshme natyrore dhe humane që dallojnë Rajonin jugor; - të evidentojë pasuritë e veçanta natyrore, demografike dhe ekonomike të këtij rajoni; - të diskutojë rreth trashëgimisë natyrore e kulturore dhe ofertat e saj për zhvillimin e turizmit; - të ndërtojë hartën e zonave kryesore turistike të Rajonit Jugor duke analizuar potencialet natyrore dhe njerëzore të këtyre zonave turistike.
<p>Republika e Kosovës</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë Republikën e Kosovës si një rajon gjeografik me kufi të qartë natyror dhe politik, veçori specifike fiziko-gjeografike, demografike dhe ekonomike; - të evidentojë diferencimin rajonal dhe tiparet gjeografike natyrore, demografike dhe ekonomike të Rajonit Perëndimor dhe Lindor të Kosovës; - të vlerësojë akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Kosovës me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe evropian; - të zhvillojë një projekt mbi mundësitë e ardhshme të integritetit politik dhe ekonomik të Kosovës në Evropë.
<p>Trevat shqiptare në Serbi</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të prezantojë trevat shqiptare në Serbi (Preshevën, Bujanovcin dhe Medvegjën), duke vlerësuar statusin politik, veçoritë specifike natyrore, demografike dhe ekonomike të tyre.
<p>Trevat shqiptare në Maqedoninë perëndimore</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë statusin politik të trevave shqiptare në Maqedoninë Perëndimore me tiparet e veçanta natyrore, demografike dhe ekonomike që i dallojnë ato nga trevat e tjera shqiptare.
<p>Trevat shqiptare në Mal të Zi</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë statusin politik dhe rëndësinë e pozitës gjeografike dhe gjeopolitike të trevave shqiptare në Mal të Zi, veçoritë e tyre natyrore, demografike dhe ekonomike, oferta e saj për zhvillimin e turizmit.

Trevat shqiptare në Greqi	- të analizojë kushtet specifike të trevave shqiptare në Greqi me vlerat e veçanta natyrore, demografike dhe ekonomike të tyre.

* Në bllokun tematik "Rajoni Perëndimor" është parashikuar të realizohet në grup një detyrë tematike mbi potencialet turistike të këtij rajoni dhe strategjitë për zhvillimin e tyre ose një projekt mbi veçoritë e urbanizimit të këtij rajoni dhe pasojat e tij. Në këtë mënyrë programi i ofron mësuesit mundësi të zgjedhë midis tyre atë që është më interesante për nxënësit, ose të punojë me 2 grupe brenda klasës duke i dhënë secilit grup detyrën e tij.

4. KËRKESAT E LËNDËS GJEOGRAFIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE E TREVAVE TË TJERA SHQIPTARE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Gjeografia	Matematika
- Temat lidhur me lëvizjet demografike, rajonet social-ekonomike, zhvillimi i sektorëve të ekonomisë.	Nxënës/i, ja: - të mbledhë të dhënat statistikore, t'i përpunojë dhe interpretojë ato matematikisht dhe grafikisht (tabela, grafikë, diagrame, etj).
Gjeografia	TIK
- Në punët praktike, punën me projekte, në një pjesë të madhe temash.	Nxënës/i, ja: - të përdorë programet bazë (Word, Power Point, Exel etj), që i duhen për përgatitjen dhe prezantimin e punëve të pavarura dhe projekteve; - të kërkojë në Internet (të dhëna, informacion, harta tematike, fizike, imazhe satelitore etj).
Gjeografia	Historia
- Harta politike e trevave shqiptare	Nxënës/i, ja: - të shpjegojë vendimet e Kongresit të Berlinit. - të përshkruajë vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër; - të njohë rezultatet e shpalljes së pavarësisë; - të shpjegojë ngjarjet e luftës në Kosovë deri në shpalljen e shtetit të pavarur.

<ul style="list-style-type: none"> - Organizimi administrativ i trevave shqiptare - Popullimi i trevave shqiptare - Trevat shqiptare në Kosovë 	<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë organizimin e Mbretërisë Ilire në bashkësi federative; - të përshkruajë organizimin e territorit shqiptar nën pushtimin romak ; - të interpretojë ndarjen e trevave shqiptare në Perandorinë Bizantine në "thema", organizimin e trevave shqiptare në mesjetë. - të argumentojë lashtësinë e popullit shqiptar; - të analizojë pushtimin osman dhe pasojat; - të përshkruajë Luftën e Dytë Botërore dhe pasojat e saj. - të përshkruajë historinë e shpalljes së Kosovës nga trojet shqiptare deri në shpalljen e republikës.
Gjeografia	Gjuha shqipe
<ul style="list-style-type: none"> - Për të gjithë blloqet tematikë 	<p>Nxënës/i, ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të interpretojë tekste dhe forma të ndryshme të komunikimit; - të përdorë aftësitë e komunikimit; - të përgatisë ese tregimtare, përshkruese dhe argumentuese; - të përzgjedhë informacionin e duhur në një vëllim të caktuar; - të shfrytëzojë teknikat e duhura gjuhësore, për të shkruar një detyrë tematike.

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Gjeografia e Republikës së Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare në klasën e dymbëdhjetë të gjimnazit do të zhvillohet me 2 orë mësimore në javë. Gjatë vitit shkollor do të zhvillohen gjithsej: **34 javë x 2 orë = 68 orë mësimore.**

Programi i kurrikulës bërthamë i kësaj lënde reflekton filozofinë aktuale të edukimit që shprehet në dokumentet themelore të kurrikulës së gjimnazit. Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të tij është e vlefshme njohja me kornizën kurrikulare të gjimnazit si dhe me standardet e shkencave shoqërore për klasat 10-12.

Në funksion të zbatimit sa më me cilësi të programit janë edhe **materialet udhëzuese** të Institutit të Zhvillimit të Arsimit.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare.

Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Realizimi i objektivave në tema, kapituj, njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

P.sh., objektivi: "Të analizojë rolin e sektorëve të veçantë të ekonomisë në zhvillimin e trevave shqiptare (ekonominë bujqësore, industrinë, tregtinë, transportin, turizmin, shërbimet dhe artizanatin)", kërkon që të gjithë nxënësve t'u jepet mundësia të analizojnë rolin e sektorëve të veçantë të ekonomisë në zhvillimin e trevave shqiptare. Nëse një mësues nuk e bën këtë, nuk ka zbatuar programin lëndor.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

Orët mësimore

Programi i lëndës Gjeografia e Republikës së Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare në klasën e dymbëdhjetë është ndërtuar në linja të strukturuar në blloqe tematikë që vijnë njëri pas tjetrit me renditje të caktuar e cila jo domosdoshmërisht duhet të ndjekë të njëjtën ecuri (renditje) gjatë vitit shkollor.

Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, ndërsa ndarja e orëve sipas blloqeve tematike mbetet në lirinë e tyre. Mësues/i,-ja mund të vendosë të përparojë më ngadalë kur vë re se nxënësit e tij/saj hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të kapitullit, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit e tij/saj demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm, por pa ndryshuar totalin e orëve mësimore.

Programi i lëndës *Gjeografia e Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare* realizohet në 68 orë mësimore vjetore, prej të cilave afërsisht **70%** e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e ***njohurive të reja lëndore*** dhe **30%** e tyre janë për ***përpunimin e njohurive*** (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Punët praktike;
- Vëzhgimet në terren;
- Përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive-bazë të tij (konceptet themelore);
- Testimin e njohurive-bazë;
- Integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve paraardhës;
- Integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (Ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme);
- Projektin kurrikular lëndor;
- Përsëritjen vjetore (Pavarësisht nga ndarja në linja ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë);
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Format, metodat, strategjitë dhe teknikat e të mësuarit duhet të jenë të shumta e të larmishme. Ato zgjidhen në përshtatje me përmbajtjen lëndore, por dhe me nivelin e nxënësve, gjendjen e bazës didaktike, etj. Gjatë orëve të ndryshme të mësimi në lëndën Gjeografia e Republikës së Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare, vëmendja e veçantë e mësuesit duhet drejtuar te lidhja organike e metodave të veçanta që ai përdor brenda një ore mësimi. Mësues/i,-ja mund të përdorë metoda të cilat janë të efektshme për të krijuar aftësi dhe qëndrime gjatë përpunimit të njohurive, të tilla si:

- Diskutimi në klasë
- Debati
- Projektet në grupe
- Ekskursioni
- Ese –ja,
- etj...

Metoda që përdor mësues/i,-ja në këtë lëndë, nuk mund të jetë me rendimentin e duhur pa mbështetjen e mjeteve didaktike, ku vendin kryesor e zënë hartat e llojeve e shkallëve të ndryshme, atlase, globe, skica, grafikë, foto, vjetarë statistikorë, manualë të të dhënave të elementëve klimatikë, hidrografikë, floristikë, zoologjikë, demografikë, etj. Vlera të mëdha për formimin e koncepteve të drejta gjeografike kanë vëzhgimet në terren, pasi në këtë mënyrë realizohet lidhja ndërmjet koncepteve abstrakte që nxënësit marrin me objektet gjeografike të vrojtura.

Punët praktike dhe projektet kurrikularë lëndorë

Punët praktike përbëjnë një pjesë integrale të kësaj lënde. Ato janë ilustrim praktik i njohurive të fituara nga nxënësit por njëkohësisht i shërbejnë dhe zhvillimit të një sërë aftësive që kanë të bëjnë me mbledhjen, përpunimin dhe interpretimin e të dhënave, (*p.sh. të analizojë ecurinë e zhvillimit të popullsisë dhe vendbanimeve në trevat shqiptare, përmes treguesve statistikorë, grafikë, etj; të ndërtojë hartën e infrastrukturës rrugore të Rajonit Juglindor duke evidentuar rolin e saj në integrimin dhe bashkëpunimin me shtetet fqinje dhe më gjerë*), etj.

Kjo lëndë krijon mundësi që nxënësit të zhvillojnë disa teknika matematikore, veçanërisht ato të shoqëruara me vlerësimin dhe manipulimin e të dhënave statistikore, ndërtimin e grafikëve, etj. Meqenëse punët praktike janë pjesë e programit dhe kanë rëndësi të veçantë për realizimin me sukses të tij, rreth 8% e orëve të përgjithshme të planifikuara në klasë, u lihen këtyre veprimtarive.

Gjithashtu, gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë **detyra tematike** (si *p.sh. të vlerësojnë përmes një detyre tematike problemet aktuale dhe të ardhmen e zhvillimit ekonomik të trevave shqiptare, duke i parë dhe trajtuar ato në kushtet e integrimit rajonal dhe evropian*); **projekte kurrikulare** (si *p.sh. të realizojnë një projekt, individual ose në grup, mbi mundësitë e zhvillimit në kushtet e reja të ndërtimit të korridorit Durrës-Prishtinë dhe të bashkëpunimit rajonal e më gjerë*); etj. Për realizimin e tyre, nxënësit kanë mundësi të përdorin teknologjinë, në mënyrë të veçantë pajisjet dhe kompjuterët.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe përforcuar konceptet e metodat themelore të kësaj lënde. Rishqyrtimi mund të bëhet me anën e një projekti, detyre tematike me karakter individual ose grupi, etj.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nivelit dhe cilësisë së arritjes së objektivave të përmbajtjes lëndore nga nxënësit është element i rëndësishëm i procesit të të mësuarit të lëndës Gjeografia e Republikës së Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare. Kjo lëndë, për vetë natyrën e gjerë të përmbajtjes së saj, mundëson shumë forma vlerësimi. Verifikimi i shkallës së përgatitjes së nxënësve duhet bërë përmes përdorimit të burimeve të ndryshme të njohurive si hartat, grafikët, skicat, etj.

Vlerësimi i nxënësve mund të jetë:

- **sistematik** (për çdo temë mësimore);
- **periodik** (në përfundim të çdo kapitulli);
- **semestral dhe vjetor**.

Ai mund të jetë përmbledhës ose formues, i planifikuar që në fillim të vitit ose i rastësishëm, në varësi të problemeve në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit. Vlerësimi mund të jetë gojor, me shkrim ose i ndërthurur. Këto forma vlerësimi duhet t'u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to.

Vlerësimi me gojë përveç kontrollit të përvetësimit të njohurive i shërben zhvillimit të disa aftësive të domosdoshme për jetën si aftësia e të shprehurit, të komunikuarit para një auditori, etj. Kjo lëndë nuk e kushtëzon mësuesin të jetë strikt në vlerësimin e nxënësve në çdo orë mësimi, por i krijon mundësi mësuesit të vlerësojë nxënësin në vijueshmëri, në ecurinë e tij.

Vlerësimi me shkrim përfshin një mori formash të cilat në një masë të konsiderueshme janë specifike për secilën lëndë. Ai mund të realizohet nëpërmjet teknikave të ndryshme, si: *veprimtarisë praktike, testimi, eseve, projekteve*, etj. Njohja dhe vlerësimi i njohurive të fituara nga nxënësit plotësohet më tej edhe nga shënimet e vetë mësuesit. Mësuesi duhet sistematikisht t'i japë mundësinë çdo nxënësi që të vlerësohet për parashtrimet e tij me shkrim.

Tema të caktuara të lëndës Gjeografia e Republikës së Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare ofrojnë mundësi për hartimin e **esëve** për probleme të ndryshme p.sh., ese për degradimin dhe shkretirizimin e peizazheve në Shqipëri. Gjatë përdorimit të esesë si mjet vlerësimi mësuesi duhet të bëjë kujdes në strukturimin e saj dhe paraqitjen sa më të kuptueshme të mënyrës së përgatitjes së saj.

Prezantimet mund të shoqërojnë detyrat me shkrim dhe mund të përdoren për vlerësime përmbledhës në fund të një njësie, kapitulli, si dhe mund të shoqërojnë një raport të shkruar si pjesë e një projekti të madh. Këto prezantime mund të jenë pjesë e portofolit të nxënësit, në formë të shkruar apo elektronike (Power Point, Word, etj). Mundësia e përdorimit në tema të caktuara të **projekteve**, në grupe apo individualisht, i krijon mundësi mësuesit të vlerësojë imagjinatën e mendimin krijues të nxënësve.

Mjaft të efektshme për matjen e rezultateve të arritjeve të nxënësve janë edhe **testimet** të cilat mund të bëhen në fund të kapitujve, semestrit ose vitit shkollor. Kjo kategori përfshin ato teknika vlerësimi të cilat përdoren në situata të strukturuar për të matur njohuritë e nxënësve. Testet janë pjesë e rëndësishme e vlerësimit të njohurive të nxënësve.

Në këtë kategori mund të përfshihen:

- *Pyetjet me fund të hapur*, si p.sh. "Cili është impakti ekonomik i turizmit në Shqipëri?" ose "Ç'pasoja solli në mjedis hapja e tokave të reja në shpatet e kodrave në Shqipëri para viteve '90?"
- *Pyetjet me përgjigje të shkurtra*, si p.sh. "Nënrajonet e Rajonit Verior – Verilindor të Shqipërisë janë _____ dhe _____".
- *Pyetjet me kombinime*, si p.sh. lidh me shigjetë:

Kollona A

Liqeni i Prespës
Liqeni i Ohrit
Liqenet e Dumresë
Liqeni i Fierzës
Liqenet e Lurës

Kollona B

Karstik
Akullnajor
Barazhi
Artificial
Bregdetar
Tektonik

- *Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë*, si p.sh. " Në bregdetin e Adriatikut mbizotëron procesi i grumbullimit për shkak të:
 - a. Prurjeve të pakta të ngurta të lumenjve në det
 - b. Prurjeve të mëdha të ngurta të lumenjve në det
 - c. Lëvizjeve ulëse të pjesës më të madhe të bregdetit
 - d. Amplitudës së madhe të baticave dhe zbaticave
- *Pyetjet E vërtetë/E gabuar*, si p.sh. "Lumi i Semanit formohet nga bashkimi i Devollit me Osumin"
 - E vërtetë E gabuar